



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1166/6 prot.

Datë 04.05.2026

V E N D I M
Nr. 579/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.05.2026, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74860-02-01-2026, me objekt “Studim Projektim për Rrjetin Ujësjiellës dhe Kanalizime, Korabi”, me fond limit 52,116,417.00 (Pesëdhjetë e dy milion e njëqindë e gjashtëmbëdhjet mijë e katërqind e shtatëmbëdhjet) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a.

Ankimues: BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk me NIPT K91810005U & “INFRATECH” shpk me NIPT K91628001D & “INSTANT.AL” shpk me NIPT L81506043D & “A.SH.Engineering” shpk me NIPT L31617003F dhe adresë Njesia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i pare, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a.
Lagjia e “Re”, mbrapa Nënprefekturës, kati i 2, godina 7-katë,
Bulqizë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02-02-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74860-02-01-2026, me objekt “Studim Projektim për Rrjetin Ujësjellës dhe Kanalizime, Korabi”, me fond limit 52,116,417.00 (Pesëdhjetë e dy milion e njëqindë e gjashtëmbëdhjet mijë e katërqind e

shtatëmbëdhjet) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a.

II.2. Në datën 17-03-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 26.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. (BOE) “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k “P.C.S COMPANY” sh.p.k & “INVICTUS” sh.p.k & ”IDEAL CONSTRUKTION AND PROJEKTION (I.C.P)”sh.p.k & “SIRELAB” sh.p.k 46,339,529.04 lekë pa tvsh, 273 pikë - kualifikuar
2. (BOE) “ARENA MK” sh.p.k & “INSTITUTI DEKLIADA ALB” sh.p.k 46,400,000 lekë pa tvsh, 282 pikë - kualifikuar
3. (BOE) “Gjeokonsult &CO” sh.p.k & “A.SH Engineering” sh.p.k & “INFRATECH” sh.p.k & “INSTANT.AL” sh.p.k 47,477,700 lekë pa tvsh skualifikuar

II.4. Në datën 07.04.2026, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 16.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar aplikimi për ankesë, me nr. 1166 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6548 e BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74860-02-01-2026, me objekt “Studim Projektim për Rrjetin Ujësjellës dhe Kanalizime , Korabi” me fond limit 52,116,417.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a.

II.6. Në datën 16.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1166/1 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6549 e BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74860-02-01-2026, me objekt “Studim Projektim për Rrjetin Ujësjellës dhe Kanalizime , Korabi” me fond limit 52,116,417.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1166/2 prot., datë 17.04.2026.

II.8. Me vendimin nr. 576/1 prot., datë 22.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1166/3 prot., datë 23.04.2026 auotoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së BOE ankimues “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me nenin 113 të ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk, KPP gjen me vend të sqarojë pozitën e ankimuesit lidhur me pagesën e tarifës financiare për procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP bën me dije se duke qenë se BOE ankimuesi ka aplikuar në sistemin e ankesave elektronike dy herë për të njëjtën procedurë prokurimi konkretisht përmes ankesave me nr. ankimi elektronik A/2026/6548 dhe me nr. 1166/2026 prot., datë 16.04.2026, (aplikim në të cilin operatori ekonomik nuk ka bashkëlidhur “Formularin e ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”), si dhe me nr. ankimi elektronik A/2026/6549 dhe me nr. 1166/1 prot., datë 16.04.2026. Operatori ekonomik ka ngarkuar mandat pagesë të ankesa me nr. ankimi elektronik A/2026/6549 dhe me nr. 1166/1 prot., datë 16.04.2026. Ndërsa ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6548 dhe me nr. 1166/2026 prot., datë 16.04.2026 rezulton pa “Formularin e ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, si dhe pa mandat pagesë dhe si rrjedhojë statusi i saj është “paraqitur mandat pagesë”, nuk do të merret në shqyrtim nga KPP për mosplotësim të kushteve formale sipas legjislacionit për prokurimin publik në fuqi.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimin si vijon: “[...] Së pari, Autoriteti Kontraktor ka kryer një vlerësim individual dhe të cunguar te ofertës së paraqitur nga BOE, duke e trajtuar “INSTANT.AL” si operator të

vetëm ekonomik, dhe jo si pjesë të një bashkimi, duke cënuar rëndë parimet e ligjit për prokurimin publik pasi: ? BOE paraqet një ofertë të vetme juridike dhe ekonomike; ? Kriteret e kualifikimit nuk mund të fragmentohen sipas çdo anëtarit në mënyrë të pavarur nga roli real; ? Vlerësimi duhet të bëhet në nivel bashkimi dhe në funksion të ndarjes së detyrimeve. Së dyti, “GJEOKONSULT & CO” sh.p.k. plotëson kërkesën për licencë projektimi Nr. 6408/32, si dhe kriterin e punimeve të ngjashme të përcaktuar në DST, ku rezulton se nga 8 kontrata të paraqitura, 2 prej tyre përmbushin në mënyrë thelbësore dhe të mjaftueshme prapun e kërkuar, duke tejkaluar mbi 50% të vlerës së kontratës, konkretisht: 1. Projektim i Ujësjiellit dhe KUZ Shkodër me vlerë 16,600,000 lekë pa TVSH 2. “Projektim KUZ Udenisht” me vlerë 11,613,544.8 lekë pa TVSH, në një total prej 28,213,545 lekë pa TVSH. Në këtë kuadër, evidentohet gjithashtu se licencë në fushën e projektimit disponohet nga tre operatorë të tjerë pjesë e BOE-së, duke garantuar përmbushjen kolektive të kërkesave teknike dhe profesionale të DST-së në përputhje me nenin 88 të VKM nr. 285/2021. Sa i përket shoqërisë “INSTANT.AL” sh.p.k., kjo e fundit nuk angazhohet në detyra të projektimit, por ka rol të përcaktuar qartë si staf mbështetës në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), në përputhje me ndarjen funksionale të përcaktuar në Akt-Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe konkretisht në Nenin 5 të saj, i cili përcakton në mënyrë të detajuar shpërndarjen e detyrimeve dhe specialitetëve ndërmjet anëtarëve të BOE-së. Në këtë drejtim, shoqëria “GJEOKONSULT & CO” sh.p.k., në cilësinë e operatorit kryesor në fushën e studim-projektimit, do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistet që posedojnë percaktimet e kerkuara ne DST sipas pikave te licences: 3. Projektues konstruktor, pikat, c-2; 4. Projektues instalator, pikat, c; 5. Projektues Vepra hidraulike pikat b,c,e,f; 8. Projektues Gjeodet, pika a, e; 9. Studim gjeologo ñ inxhinierike ñ Hidrogeologjike, pika e; 12. Studime te sizmologjise inxhinierike, pika d dhe e. Shoqeria “INFRATECH” shpk, ne kuadrin e bashkepunimit do te realizoje: Realizimin e studimit dhe projektimit te objekteve qe lidhen me specialitet qe mbulohen nga specialistet qe posedojne percaktimet e kerkuara ne DST sipas pikave te licences: Staf mbeshtetes Hidroteknik. Shoqëria “INFRATECH” sh.p.k. angazhohet në funksione mbështetëse teknike hidroteknike. Në këtë kuptim, shoqëria “INSTANT.AL” sh.p.k. kufizohet ekskluzivisht në ofrimin e stafit ndihmës IT, konkretisht një pozicion të vetëm të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.5 të DST-së, dhe nuk ka asnjë angazhim në realizimin e detyrave të projektimit, të cilat mbeten tërësisht në kompetencën e operatorëve të licencuar në këtë fushë. Ndërkohë, Shoqëria “INSTANT.AL” shpk, ne kuadrin e bashkepunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit te objekteve qe lidhen me specialitet qe mbulohen nga specialistet qe posedojne percaktimet e kerkuara ne DST sipas pikave te licences: Staf mbeshtetes IT. Shoqëria “A.SH.Engineering” sh.p.k, ne kuadrin e bashkepunimit do te realizoje: Realizimin e studimit dhe projektimit te objekteve qe lidhen me specialitet qe mbulohen nga specialistet qe posedojne percaktimet e kerkuara ne DST sipas pikave te licences: 5. Projektues Vepra hidraulike pikat b,c,e,f 8. Projektues Gjeodet, pika a, e. Rrjedhimisht, kërkesa për përmbushjen nga ana e “INSTANT.AL” sh.p.k. të kriterëve të punimeve të ngjashme dhe licencimit në projektim përbën një interpretim të zgjeruar dhe të pabazuar të DST-së, në kundërshtim me ndarjen funksionale të përgjegjësisë të parashikuar në marrëveshjen e bashkëpunimit dhe me parimin e përmbushjes kolektive të kriterëve nga BOE, sipas nenit 88 të VKM nr. 285/2021. Së treti, në lidhje me rolin real të shoqërisë “INSTANT.AL” sh.p.k. në kuadër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, referuar Marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, evidentohet se kjo shoqëri ka një

rol ekskluzivisht mbështetës në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), pa asnjë detyrim apo angazhim në realizimin e komponentëve të studim-projektimit apo të projektimit teknik të objektit të kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën nr. 9 të dokumenteve të tenderit të ndryshuar, kriteret e veçanta të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

ISHTE:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përllogaritur të objektit që prokurohet.*

- a) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*
- b) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

BEHET:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përllogaritur të objektit që prokurohet.*

- a) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*
- b) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.*

III.2.2. Në shtojcën nr. 6 të dokumenteve të tenderit, “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;*
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Termet e Referencës bashkelidhur kesaj DST të përcaktuara nga AK.

.....

III.2.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk ndër të tjera ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Akt marrëveshje bashkëpunimi, datë 12.03.2026 lidhur ndërmjet “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk ku në nenin 3 – “Pjesëmarrja në realizimin e shërbimit”, përcaktohet si vijon: “Pjesëmarrja në grup përcaktohet sipas raporteve 83.3 % shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk, 4 % shoqëria “Infatech” SHPK, 4 % “Instant.Al” shpk dhe 8.7 % shoqëria “A.SH Engineering” shpk. Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk do të ketë të drejtën e

përfaqësimit në kontaktet me investitorin dhe cdo përfaqësim tjetër që do të jetë i nevojshëm gjatë kryerjes së aktivitetit të realizimit të kontratës së shërbimit.

Në nenin 5 – “Ndarja e punimeve dhe detyrimet” përcaktohet se: “Të gjitha shoqëritë do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, kapacitetet financiare dhe eksperiencën e tyre si grup i vetëm, përkatësisht në përputhje me ndarjen e punimeve në pjesëmarrje, për të realizuar me sukses kontratën.

Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë:

Realizimin e studimit dhe prijhektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimit e kërkuara në DST sipas pikave të licencës:

3.Projektues konstruktor, pikat, c-2

4.Projektues instalator, pikat, c

5.Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f.

8.Projektues gjeodet, pika a,e

9.Studim gjeologo-inxhinierike-hidrogeologjike, pika e

12. studime të sizmiologjisë inxhinierike, pika d dhe e

Shoqëria “Infratech” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë:

Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialist që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës:Staf mbështetës hidroteknik

Shoqëria “Instant. AL” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës IT.

Shoqëria “A.SH Engineering” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës:

5.Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f. 8.Projektues gjeodet, pika a, e.

- Kontratë shërbimi me nr. 478/62 prot., datë 19.11.2025, me objekt “Blerje shërbimi për instalim dhe konfigurim fireëall, router, sëitch”, lidhur ndërmjet shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Knaanalizime Korçë sh.a dhe shoqërisë “INSTANT.AL” SHPK, vlera totale e kontratës 4,973,000 lekë pa TVSH, 5,967,600 lekë me TVSH.
- Kontratë shit-blerje nr. 6815/30 prot., datë 04.09.2024 me objekt “Loti 1: “Blerje pajisje elektronike për Qendrën Multifunkionale për të rinjtë, Fier”, lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe shoqërisë “INSTANT.AL” shpk, vlera e kontratës 2 340 000 lekë pa TVSH, 2 808 000 lekë me TVSH.
- Kontratë me nr. 4434 prot., datë 07.08.2023 me objekt “Ndërtim puse duplikant, rrethim dhe pastrim të puseve ekzistuese në zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale UK Durrës”, lidhur ndërmjet Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha dhe BOE A.K.M shpk & “Alba Konstruktion” SHPK & “A.SH Engineering” SHPK, vlera e kontratës 49,200,000 lekë pa tvsh, 59,040,00 lekë me tvsh.
- Kontratë shërbimi minikontrata me objekt “Studim projektim “Ndërtimi godinës Shtesë, Fakulteti i Shkencave të natyrës”, me nr. 14214/14 prot., datë 11.04.2023 lidhur

ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” shpk, me vlerë të kontratës 20,918,898 lekë me TVSH. Bashkëlidhur vërtetim realizimi me nr. 17980/1 prot., datë 09.06.2025 + fatura tatimore.

- Kontratë shërbimi me nr. 22656/19 prot., datë 09.10.2023, me objekt “Minikonkursi me objekt: Studim-projektim “Rehabilitimi infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative nr. 4+8+12”, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe BOE “Infratech” shpk & “Engineering Consulting Group” shpk, vlera e kontratës 4,810,200 lekë me tvsh. Bashkëlidhur fatura tatimore + vërtetim realizimi kontrate.
- Kontratë nr. 647/11 prot., datë 12.07.2023 me objekt “Loti I: Batimetria e Liqenit Fierzë, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a dhe operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” shpk, totali me tvsh 125,760,000 lekë, totali pa tvsh 104,800,00 lekë. Vërtetim realizimi kontrate + fatura.
- Kontratë me nr. 617/37 prot., datë 01.11.2023 me objekt “Studim projektim :Ndërtim i sistemeve të kanalizimeve të Njësisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, lidhur ndërmje Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a dhe shoqërisë “Gjeokonsult & Co” shpk me vlerë 13,936,253.76 lekë me tvsh, vlera e kontratës pa tvsh 11,631,544.80 lekë. Bashkëlidhur formular vlerësimi+fatura tatimore.
- Kontratë shërbimi me nr. 525/71 prot., datë 24.07.2024 Minikontrata me objekt “Studim-Projektim “Rehabilitimi i rrugës hyrëse në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të trafikut”, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” shpk, me vlerë 951,600 lekë me tvsh. Bashkëlidhur vërtetim realizimi + fatura tatimore.
- Kontratë me nr. 1106/4 prot., datë 05.07.2024 me objekt “Studim projektim ndërtimi i rrjetit të Ujësjellësit + KUZ për zonën e Shirokës dhe Ndërtimi i rrjetit KUZ për zonën Zogaj të Bashkisë Shkodër”, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK, me vlerë 16,600,000 lekë pa TVSH, 19,920,000 lekë me TVSH. Bashkëlidhur formular vlerësimi + fatura tatimore.
- Kontratë shërbimi me nr. 22655/48 prot., datë 09.10.2023 me objekt “Minikonkursi me objekt: “Studim projektim “Rikualifikim i blloqeve të banimit në rrugën “Babë Rexha”, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe BOE “INFRATECH” shpk & “Engineering Consulting Group” shpk, me vlerë shërbimi 3,039,720 lekë me tvsh. Bashkëlidhur fatura tatimore + vërtetim realizimi.
- Kontratë shërbimi me nr. 22655/19 prot., datë 09.10.2023 me objekt “mMinikonkursi me objekt: “Studim projektim “Rehabilitimi infrastrukturës rrugore në Njësinë administrative nr. 4+8+12”, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe BOE “INFRATECH” shpk & “Engineering Consulting Group” shpk, me vlerë shërbimi 4,810,200 lekë me tvsh. Bashkëlidhur fatura tatimore + vërtetim realizimi.
- Kontratë me nr. 2172 prot., datë 19.06.2024 me objekt “Hartimit i planit të integruar të menaxhimit për “Parku natyror liqeni i shkodrës, vkm nr. 60, datë 26.01.2022, Aneksi 17”, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe operatorit ekonomik “Infratech” shpk, me vlerë totale 11 200 000 lekë pa tvsh, 13 440 000 lekë me tvsh. Bashkëlidhur Formular vlerësimi + fatura tatimore.

- Kontratë me nr. 3967 prot., datë 21.11.2023, me objekt “Studim mbi rëndësinë në ekosistem të lagunave, duke përfshirë statusin e mbrojtjes në varësi të rëndësisë, si dhe nënzonimin përkatës”, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe operatorit ekonomik “Infratech” shpk me vlerë totale 13 816 600 lekë pa tvsh, 16 579 920 lekë me tvsh. Bashkëlidhur faturë tatimore.
- Kontratë shërbimi me nr. 12061/44 prot., datë 1.07.2022 me objekt “Rehabilitim i rrugëve të bllokut 48 (pjesa e mbetur nga IPA 2012)”, Njësi administrative nr. 4”, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe BOE “Infratech” shpk & “Engineering Consulting Group” shpk & “Tesla Vizion” shpk, vlera e kontratës 4,488,000 lekë me tvsh. Bashkëlidhur letër reference + fatura tatimore.
- Kontratë shërbimi me nr. 2518 prot., datë 16.11.2022 me objekt “Plani i integruar i menaxhimit për parkun kombëtar mali i Dajtit”, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe shoqërisë “Gjeokonsult & Co” shpk, me vlerë 11,680,000 lekë pa TVSH, 14,016,000 lekë me TVSH. Bashkëlidhur fatura tatimore + formular vlerësimi.
- Kontratë nr. 1616 prot., datë 03.07.2023 me objekt “Projekt-Preventive Hidrogeologjike”, lidhur ndërmjet Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sha dhe shoqërisë “A.SH Engineering” shpk, vlera totale 659,115 lekë pa tvsh. Bashkëlidhur fatura tatimore.
- Kontratë me nr. 1066/3 prot., datë 26.06.2023 me objekt “Blerje pajisje elektronike për EKB” lidhur ndërmjet entit kombëtar të banesave dhe operatorit ekonomik “Instant.AL” SHPK, vlera pa tvsh 1,330,000 lekë pa tvsh, 1,596,000 lekë me tvsh.
- Kontratë shërbimi (punime gjeologo-inxhinierike për objektin skaliturë Toëer) me nr. 11 prot, datë 21.02.2025, lidhur ndërmjet shoqërisë Babasi Coo shpk dhe shoqërisë “Gjeokonsult & Co” shpk. Bashkëlidhur faturë tatimore me nr. 48/2025, datë 29.04.2025 me vlerë 680 000 lekë pa tvsh, 816 000 lekë me TVSH.
- Kontratë me nr. 190/9 prot., datë 26.06.2025 me objekt “Blerje shërbim mirëmbajtje IT”, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes së dekorit dhe eventeve dhe operatorit ekonomik “Instant.AL” SHPK, me vlerë totale 175,000 lekë pa tvsh, vlera totale me tvsh 210,000 lekë.
- Kontratë me nr. 476/8 prot., datë 21.10.2024 me objekt “Blerje “Pajisje informatike”, lidhur ndërmjet Portit Detar sh.a Sarandë dhe operatorit ekonomik “Instant.AL” shpk, vlera totale e kontratës 1 074 042 lekë me tvsh, vlera pa tvsh 895 035 lekë.
- Kontratë shërbimi me nr. 2366/18 prot., datë 15.12.2025 lidhur ndërmjet Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe shoqërisë “Instant.AL” shpk me objekt “Loti 2: Shërbim mirëmbajtje “Full Risk” për infrastrukturën e Rrjetit dhe Sigurisë”, me vlerë totale 1 800 000 lekë pa tvsh, 2 160 000 lekë me TVSH.
- Kontratë furnizimi me nr. 3536/17 prot., datë 20.11.2024 lidhur ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe operatorit ekonomik “Instant.AL” shpk, me objekt “Blerje e sistemit të menaxhimit të konsultimit publik (OSHc, OJF, palë interesi dhe lobistë) dhe shërbim mirëmbajtje 48 muaj”, vlera totale 8,994,800 lekë pa tvsh, 10,793,760 lekë me tvsh.
- Kontratë furnizim mallrash, me nr. 5457 prot., datë 21.07.2025 me objekt “Blerje kompjutera dhe printera për Bashkinë Krujë”, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe shoqërisë “Instant.AL” SHPK, vlera pa tvsh 840,700 lekë, vlera me tvsh 1,008,840 lekë.

- Faturë tatimore nr. 53/2023, datë 27.10.2023 me vlerë totale pa tvsh 699 990 lekë, shuma totale me tvsh 839,988 lekë. Shitës “Instant.AL” shpk, blerës Universiteti “Aleksandër Moisiu”.
- Faturë tatimore nr. 45/2024, datë 26.07.2024 me vlerë totale pa tvsh 1,565,466 lekë, shuma totale me tvsh 1,878,559.20 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Shoqëria rajonale ujësjellës kanalizime Korçë sha.
- Faturë tatimore nr. 34/2024, datë 25.06.2024, vlera totale pa TVSH 820,000 lekë, vlera totale me TVSH 984,000 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës shkolla Luigj Gurakuqi.
- Faturë tatimore nr. 102/2025, datë 30.06.2025, vlera totale pa tvsh 710,000 lekë, vlera totale me tvsh 852,000 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Prefektura e Qarkut fier.
- Faturë tatimore nr. 44/2024, datë 25.07.2024, me vlerë totale pa tvsh 892,300 lekë, vlera totale me tvsh 1,070,760 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Presidenca e Republikës.
- Faturë tatimore nr. 5/2024, datë 02.02.2024 me vlerë totale pa tvsh 370,500 lekë, vlera totale me tvsh 444,600 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Qendra shëndetësore Vorë.
- Faturë tatimore nr. 39/2024, datë 10.07.2024 me vlerë totale pa tvsh 140 000 lekë, vlera totale me tvsh 168,000 lekë me tvsh. Shitës Instant.AL shpk, blerës Poliklinika nr. 8.
- Faturë tatimore nr. 67/2023, datë 19.12.2023, vlera totale pa tvsh 608 000 lekë, vlera totale me tvsh 729 600 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Instituti Transportit.
- Faturë tatimore nr. 35/2023, datë 17.07.2023, vlera totale pa tvsh 1 330 000 lekë, vlera totale me tvsh 1 596 000 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Enti Kombëtar i Banesave.
- Faturë tatimore nr. 30/2025, datë 17.03.2025 me vlerë totale pa tvsh 725,000 lekë, vlera totale me tvsh 870,000 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Berat.
- Faturë tatimore nr. 125/2025, datë 25.07.2025 me vlerë totale pa tvsh 840,700 lekë, vlera totale me tvsh 1 008 840 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Krujë.
- Faturë tatimore nr. 32/2024, datë 14.06.2024 me vlerë totale pa tvsh 470 000 lekë, vlera totale me tvsh 564 000 lekë. Shitës Instant. Al shpk, blerës Bashkia Pukë.
- Faturë tatimore nr. 26/2024, datë 03.06.2024, me vlerë totale me tvsh 2,879,280 lekë, vlera totale pa tvsh 2,399,400 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Durrës.
- Faturë tatimore nr. 51/2023, datë 16.10.2023, me vlerë pa tvsh 2,698,900 lekë, vlera totale me tvsh 3,238,680 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Sarandë.
- Faturë tatimore nr. 63/2024, datë 26.09.2024, me vlerë totale pa tvsh 1,915,800 lekë pa tvsh, vlera totale me tvsh 2,298,960 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Gjirokastër.
- Faturë tatimore nr. 108/2024, datë 13.12.2024, m vlerë totale pa tvsh 1,150,000 lekë, shuma totale me tvsh 1,380,000 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Devoll.
- Faturë tatimore nr. 71/2023, datë 26.12.2023, vlera totale pa tvsh 899 910 lekë, vlera totale me tvsh 1 079 892 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Mat.
- Faturë tatimore nr. 64/2024, datë 01.10.2024, me vlerë totale pa tvsh 5,509,400 lekë, vlera totale me tvsh 6,611,280 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Bashkia Vlorë.
- Faturë tatimore nr. 17/2025, datë 17.02.2025, me vlerë totale pa tvsh 4 597 494 lekë, vlera totale me tvsh 5 516 992.80 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Universiteti Politeknik i Tiranës.
- Faturë tatimore nr. 123/2024, datë 31.12.2024, me vlerë totale pa tvsh 6 500 331 lekë, vlera totale me tvsh 7 800 397.20 lekë. Shitës Instant.AL shpk, blerës Universiteti Politeknik i Tiranës.

- Faturë tatimore nr. 55/2025, datë 15.04.2025, me vlerë totale pa tvsh 1 789 000 lekë, vlera totale me tvsh 2 146 800 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Bashkia Vau Dejës.
- Faturë tatimore nr. 31/2023, datë 03.07.2023, me vlerë totale pa tvsh 320 500 lekë, vlera totale me tvsh 384 600 lekë. Shitës Instant.AI SHPK, blerës Bashkia Durrës.
- Faturë tatimore nr. 66/2023, datë 18.12.2023, me vlerë totale pa tvsh 140 000 lekë, vlera totale me tvsh 168 000 lekë. Shitës Instant.AI SHPK, blerës Fakulteti i Drejtësisë.
- Faturë tatimore nr. 15/2022, datë 02.07.2022, me vlerë totale pa tvsh 50 000 lekë, vlera totale me tvsh 60 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës MCE.
- Faturë tatimore nr. 18/2022, datë 25.07.2022, me vlerë totale pa tvsh 25 000 lekë, vlera totale me tvsh 30 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Ambasada Sh.B.A.
- Faturë tatimore 34/2022, datë 11.10.2022 me vlerë totale pa tvsh 25 0000 lekë, vlera totale me tvsh 30 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Ambasada Sh.B.A.
- Faturë tatimore nr. 7/2023, datë 02.02.2023, me vlerë totale pa tvsh 50 000 lekë, shuma totale me tvsh 60 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Ambasada Sh.B.A.
- Faturë tatimore nr. 26/2023, datë 31.05.2023, vlera totale pa tvsh 37 500 lekë, vlera totale me tvsh 45 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Ambasada Sh.B.A.
- Faturë tatimore nr. 65/2023, datë 12.12.2023, vlera totale pa tvsh 565 000 lekë, vlera totale me tvsh 678 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Ambasada Sh.B.A.
- Faturë tatimore nr. 14/2024, datë 09.04.2024, vlera totale pa tvsh 250 600 lekë, vlera totale me tvsh 300 720 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit.
- Faturë tatimore nr. 94/2024, datë 18.11.2024, vlera totale pa tvsh 565 000 lekë, vlera totale me tvsh 678 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Sarandë Sha.
- Faturë tatimore 112/2024, datë 19.12.2024, vlera totale pa tvsh 500 000 lekë, vlera totale me TVSH 600 000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.
- Faturë tatimore nr. 32/2025, datë 19.03.2025, vlera totale pa TVSH 4,674,800 lekë, vlera totale me TVSH 5,609,760 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Kuvendi.
- Faturë tatimore nr. 54/2025, datë 14.04.2025, shuma totale pa tvsh 4,424,000 lekë, vlera totale me TVSH 5,308,800 lekë. Shitës Instant.AI SHPK, blerës Atom SHPK.
- Faturë tatimore nr. 59/2025, datë 17.04.2025, vlera totale pa tvsh 13,200,000 lekë, vlera totale me tvsh 15,840,000 lekë. Shitës Instant.AI shpk, blerës Atom shpk.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.7. Në nenin 92 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

III.2.8. Në nenin 41, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimitarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimi”.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me

kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.10. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues me arsyetimin se: “[...] Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në plotësim të përsaj pikë të kriterëve të vecnata të kualifikimit verën se operatori ekonomik “INSTANT.AL” shpk nuk plotëson punën e ngjashme për shkak të natyrës së punëve të cilat ka paraqitur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme, Komisioni konstaton se operatori, dëshmon se ka kryer punime të ngjashme vetëm në furnizim mallrash si psh, kompjutera, printera, shërbime IT, mirmbajtje faqesh, por në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për studim projektive sipas objektit të prokurimit, theksojme faktin se studim projektimet kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatori me anë të kontratës së paraqitur, pasi edhe metodologjia e shërbimit të tyre është e ndryshme . Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë në vlerë, por duhet parë në lidhje me të gjithë natyrën e prokurimit që zhvillon autoriteti kontraktor [...]”, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor specifikimet teknike, detyrat e projektimit të publikuara në SPE nga autoritetit kontraktor, duke analizuar komponentin natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Instant.AL” SHPK anëtar i BOE ankimues me objektin e prokurimit, i cili përbën edhe arsyen e skualifikimit nga KVO-ja.

Nga verifikimi i dokumentave të tenderit dhe kriterit të veçantë të kualifikimit, pikës 2.3.1 të shtojcës nr. 9 të dokumentave të tenderit, Komisioni thekson, se me akt nënligjor, është rregulluar diskrecioni i vendosur nga ligji lidhur me përvojën e ngjashme, ku në rastin e kontratave për shërbime ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ku të shënohen ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e shërbimit të realizuar, me një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës tre vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga BOE ankimues, nga ku Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit,

pikës 2.3.1 të shtojcës nr. 9 të dokumentave të tenderit, BOE ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.3 të këtij vendimi.

Referuar kontratës “Akt marrëveshje bashkëpunimi, datë 12.03.2026 lidhur ndërmjet “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk, të ngarkuar në SPE nga BOE ankimues, Komisioni konstaton, se në kontratë përcaktohet si vijon: “[...] Neni 3 “Pjesëmarrja në realizimin e shërbimit”: “Pjesëmarrja në grup përcaktohet sipas raporteve 83.3 % shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk, 4 % shoqëria “Infatech” SHPK, 4 % “Instant.AL” shpk dhe 8.7 % shoqëria “A.SH Engineering” shpk. Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk do të ketë të drejtën e përfaqësimit në kontaktet me investitorin dhe cdo përfaqësim tjetër që do të jetë i nevojshëm gjatë kryerjes së aktivitetit të realizimit të kontratës së shërbimit”. Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “Instant.AL” SHPK merr përsipër të kryejë 4 % të punimeve. Ndërsa në nenin 5 “Ndarja e punimeve dhe detyrimet” përcaktohet se: “Të gjitha shoqëritë do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, kapacitetet financiare dhe eksperiencën e tyre si grup i vetëm, përkatësisht në përputhje me ndarjen e punimeve në pjesëmarrje, për të realizuar me sukses kontratën. Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimit e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: 3.Projektues konstruktor, pikat, c-2, 4. Projektues instalator, pikat, c, 5. Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f, 8. Projektues gjeodet, pika a,e, 9. Studim gjeologo-inxhinierike-hidrogeologjike, pika e, 12. studime të sizmiologjisë inxhinierike, pika d dhe e. Shoqëria “Infratech” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialist që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës hidroteknik. Shoqëria “Instant. AL” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës IT. Shoqëria “A.SH Engineering” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: 5.Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f, 8.Projektues gjeodet, pika a, e.”.

III.2.11 Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues, Komisioni konstaton, se arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues lidhet me ngjashmërinë e shërbimit të kontratave të realizuara nga operatori ekonomik “Instant.AL” shpk anëtar i BOE ankimues dhe jo me vlerën apo afatin e realizimit të tyre. Konkretisht nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, shtojcës nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, të ngarkuar në SPE Komisioni konstaton, se ky projekt ka si synim projektimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të linjës së transmetimit për qytetin e Peshkopisë dhe për fshatrat që ndodhen përgjatë linjës së transmetimit nga burimet natyrore të Radomirës. Projekti parashikon ndërtimin e një linje të re transmetimi, si dhe rrjetin e shpërndarjes për fshatrat përfituese. Objektivat specifike të punës përfshijnë: – Studimin e burimeve ujore dhe përcaktimin e kapacitetit të tyre furnizues; – Rehabilitimin e vepres së marrjes – Trasimin dhe projektimin e linjës së transmetimit për të përcjellë ujin në mënyrë efikase deri në qytetin e

Peshkopisë; – Projektimin e rrjetit shpërndarës për fshatrat përgjatë linjës së transmetimit, hartim projekt ideje; – Sigurimin e presioneve të duhura në rrjet për çdo përdorues; 3 – Përlllogaritjen e kostove dhe analizën e përfitimeve ekonomike dhe sociale. Ky projekt ka për qëllim të shërbejë si bazë për zbatimin praktik dhe të ndihmojë në përgatitjen e dokumentacionit teknik për aplikime për financime ose leje ndërtimi.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP vëren, se bashkimi i operatorëve ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me shërbimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës BOE ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.2.3 të këtij vendimi.

Referuar dokumentacionit të sipërpërmendur, si dhe nisur nga arsyeja e skualifikimit se “operatori ekonomik “*INSTANT.AL*” shpk nuk plotëson punën e ngjashme për shkak të natyrës së punëve të cilat ka paraqitur”, Komisioni konstaton, se referuar kontratave të dorëzuara nga BOE ankimues në SPE, rezulton se operatori ekonomik “*INSTANT.AL*” shpk ka kryer punime si vijon: punime të ngjashme në furnizim mallrash si psh, kompjutera, printera, antivirus, tastierë, mouse, switch, laptop, kompjutera workstation, monitor televizori, bateri UPS, fotokopje multifunction, mirëmbajtje e sistemeve informatike, krijim faqesh web, shërbime IT, mirëmbajtje faqesh.

Referuar kontratave dhe faturave të dorëzuara në SPE, dhe konkretisht referuar punimeve të kryera nga operatori ekonomik “*INSTANT.AL*” SHPK si: “blerje shërbimi për instalim, konfigurim firewall, router, switch, blerje pajisje elektronike, blerje pajisje elektronike, blerje shërbim mirëmbajtje it, pajisje informatike, shërbim mirëmbajtje për infrastrukturën e rrjetit dhe sigurisë, blerje sistemi dhe shërbim mirëmbajtje, blerje kompjutera dhe printera”, si dhe specifikimeve teknike, detyrave të projektimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni gjykon, se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik “*INSTANT.AL*” SHPK kanë si objekt: furnizim mallrash si psh, kompjutera, printera, shërbime IT, mirëmbajtje faqesh, por në asnjë prej kontratave: nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për studim projektive sipas objektit të prokurimit, për rrjedhojë, kontratat e paraqitura nuk përbëjnë shërbime të ngjashme në fushën studim projektive sipas objektit të prokurimit, në kuptim të pikës 2.3.1 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit. Sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik, ngjashmëria e punëve vlerësohet sipas funksionit teknik dhe objektit. Edhe në vlerësim tërësor të kontratave të paraqitura: nuk ekziston një grup kontratash homogjene në studim projektive sipas objektit të prokurimit; nuk provohet realizimi i shërbimeve sipas karakteristikave të kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji, për rrjedhojë, nuk përmbushet kriteri i veçantë i kualifikimit, pika 2.3.1 të shtojcës nr. 9, të dokumentave të tenderit përse i përket ngjashmërisë së punëve të kryera.

Operatori ekonomik “*Instant.AL*” sh.p.k. anëtar i BOE “*GJEOKONSULT & CO*” shpk & “*INFRATECH*” shpk & “*INSTANT.AL*” shpk & “*A.SH.Engineering*” SHPK nuk ka provuar përvojë të mëparshme në shërbime të ngjashme në fushën e studim projektimit. Referuar pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato

teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, si dhe referuar akt marrëveshjes për bashkimin e operatorëve ekonomik, rezulton se operatori ekonomik “Instant.AL” shpk ka marrë përsipër të realizojë 4 % të shërbimeve të kontratës objekt prokurimi, edhe pse në nenin 5 të kësaj akt marrëveshje BOE ankimues ka përcaktuar se operatori ekonomik “Instant.AL” SHPK *“në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulojnë nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës IT”*, nga momenti që operatori ekonomik anëtar i BOE ka marrë përsipër të realizojë 4 % të shërbimeve, me kontratat e dorëzuara duhet të dëshmojë përvojë të ngjashme me objektin e prokurimit. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 88 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, është që secili nga operatorët e bashkimit të disponojë kapacitetet teknike profesionale në përputhje me përqindjen që kanë marrë përsipër të realizohet nga secili prej tyre. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të shërbimeve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Instant.AL” SHPK anëtar i BOE ankimues duhet të dëshmojë eksperiencë të ngjashme në përputhje me përqindjen që ka marrë përsipër të realizohet.

Sa më sipër, KPP gjykon, se referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kontratat dhe faturat e mësipërme të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK pjesë e BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” SHPK nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.1. të kapacitetit teknik, lidhur me ngjashmërinë e shërbimeve të kryera, rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit të KVO-së është e drejtë.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: *“Së treti, në lidhje me rolin real të shoqërisë “INSTANT.AL” sh.p.k. në kuadër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, referuar Marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, evidentohet se kjo shoqëri ka një rol ekskluzivisht mbështetës në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), pa asnjë detyrim apo angazhim në realizimin e komponentëve të studim-projektimit apo të projektimit teknik të objektit të kontratës. Në mënyrë eksplicite,*

INSTANT.AL nuk ushtron aktivitet projektimi në kuadër të kësaj procedure dhe nuk është pjesë e zinxhirit teknik të hartimit të projektit, por kontribuon vetëm në funksione ndihmëse IT, në përputhje me ndarjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje. Ky rol mbështetës është i lidhur në mënyrë funksionale me mbështetjen e inxhinierit elektronik të kërkuar në pikën 2.3.4 të DST, rol ky që rezulton i plotësuar nga Drejtuesi Teknik i shoqërisë iGJEOKONSULT & COË sh.p.k., i cili mbulon dhe garanton përmbushjen e këtij kriteri në kuadër të kapaciteteve të bashkimit. Në këto kushte, pjesëmarrja e *INSTANT.AL* sh.p.k. kufizohet në asistencë teknike IT dhe nuk shtrihet në fushën e projektimit apo në komponentët teknikë të studim-projektimit të kontratës. Për rrjedhojë, çdo kërkesë për licencim apo eksperiencë në projektim ndaj këtij operatori është e pabazuar, pasi bie ndesh me natyrën reale të angazhimit të tij në BOE dhe me parimin e proporcionalitetit në vlerësimin e kapaciteteve. Në asnjë procedurë tenderuese që lidhet me projekte sistemesh softërike nuk kërkohej staff apo kompani me licence në projektim sipas VKM 943, datë, 28.12.2016, kjo për vetë faktin se në kuadrin rregullator në fuqi nuk ekziston asnjë kategori specifike licence në fushën e teknologjisë së informacionit (IT). Vlen të theksohet se kjo shoqëri ka një pjesëmarrje prej vetëm 4% në realizimin e kontratës dhe jo 8.7%, siç është vlerësuar në arsyetimin e skualifikimit, duke reflektuar një pasaktësi faktike me ndikim të drejtpërdrejtë në vlerësimin e kërkesave të aplikueshme. Ky keqinterpretim i të dhënave thelbësore të marrëveshjes së bashkëpunimit çon në mënyrë të pashmangshme në një shtrembërim të analizës juridike dhe në aplikimin e padrejtë të kriterëve të kualifikimit, duke krijuar një perceptim të arsyeshëm për një qasje jo plotësisht objektive në vlerësim. Theksojmë se kërkesa për pajisje me licencë projektimi apo për dëshmi të eksperiencës në projektim për një subjekt që nuk kryen veprimtari projektimi, por ka rol të kufizuar mbështetës, është disproporcionale. Aplikimi i këtyre kërkesave përbën një zgjerim të pajustifikuar të kriterëve të kualifikimit përtej rolit real të pjesëmarrjes së operatorit në BOE dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, si dhe me qëllimin dhe frymën e nenit 88 të VKM nr. 285/2021, i cili kërkon që vlerësimi të bëhet në mënyrë të ndarë dhe funksionale, në përputhje me kontributin real të secilit anëtar të bashkimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit, në pikën 2.3.2 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

ISHTE:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 3.c2 Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 4.f Sisteme kundra zjarrit
- 5.b Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi

- 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime
- 5.e Vepra te trajtimit te ujit
- 5.f Projekte vepra hidroteknike, galeri e tunele hidrulike, marrje uji, shkarkimi.
- 8.a Rivelime inxhinierike.
- 8.c Sisteme GIS.
- 8.d Bazamente gjeodezike
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.e Studime e Projektme hidrogjeologjike
- 10.e Kabina elektrike te rrjetit shperndares – linja te tensionit te ulet – te mesem
- 12d Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse si: hidrocentrale, termocentrale, porte, aeroporte, tunele per vepra hidroteknike, bazamente per ngarkesa te mbedha dhe objekte industriale.
- 12e Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet e shpate me qendrueshmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrifeta me mundesi lengezimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.**

BEHET:

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 3.c2 Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 5.b Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi
- 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime
- 5.e Vepra te trajtimit te ujit
- 5.f Projekte vepra hidroteknike, galeri e tunele hidrulike, marrje uji, shkarkimi.
- 8.a Rivelime inxhinierike.
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.e Studime e Projektme hidrogjeologjike

- 12d Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse si: hidrocentrale, termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale.
- 12e Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet e shpate me qendrueshmeri të ulet dhe për troje ndërtimore të shkrifeta me mundësi lëngëzimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studimit projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.**

III.3.2 Në përmbushje të kriterit të mësipërm BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRA TECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk ndër të tjera ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Akt marrëveshje bashkëpunimi, datë 12.03.2026 lidhur ndërmjet “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRA TECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk ku në nenin 3 – “Pjesëmarrja në realizimin e shërbimit” përcaktohet si vijon: “Pjesëmarrja në grup përcaktohet sipas raporteve 83.3 % shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk, 4 % shoqëria “Infatech” SHPK, 4 % “Instant.Al” shpk dhe 8.7 % shoqëria “A.SH Engineering” shpk. Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk do të ketë të drejtën e përfaqësimit në kontaktet me investitorin dhe cdo përfaqësim tjetër që do të jetë i nevojshëm gjatë kryerjes së aktivitetit të realizimit të kontratës së shërbimit”.

Në nenin 5 – “Ndarja e punimeve dhe detyrimet”, përcaktohet se: “Të gjitha shoqëritë do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, kapacitetet financiare dhe eksperiencën e tyre si grup i vetëm, përkatësisht në përputhje me ndarjen e punimeve në pjesëmarrje, për të realizuar me sukses kontratën.

Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë:

Realizimin e studimit dhe prijhektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbuloohen nga specialistët që posedojnë përcaktimit e kërkuara në DST sipas pikave të licencës:

3.Projektues konstruktor, pikat, c-2

4.Projektues instalator, pikat, c

5.Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f.

8.Projektues gjeodet, pika a,e

9.Studim gjeologo-inxhinierike-hidrogeologjike, pika e

12. studime të sizmologjisë inxhinierike, pika d dhe e

Shoqëria “Infratech” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë:

Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialist që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës hidroteknik.

Shoqëria “Instant. AL” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës IT.

Shoqëria “A.SH Engineering” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës:

5.Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f

8.Projektues gjeodet, pika a, e.

- Licencë nr. 6130/14, në Projektim, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në emër të shoqërisë “Infratech” shpk.
- Licencë nr. 6932/10, në Projektim, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në emër të shoqërisë “A.SH Engineering” shpk.
- Licencë nr. 6408/32, në Projektim, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në emër të shoqërisë “Gjeokonsult & Co” shpk.

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë*

kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori

ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.3.6. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPPsë, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.3.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. 4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.3.8 Në KREUN III LICENCAT PROFESIONALE - KATEGORITË, ELEMENTËT DHE KUFIZIME, neni 16 të VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, parashikohet shprehimisht: “1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrijë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim

e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim. 2. Kategorive e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, përfitohen mbështetur në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale sipas kushteve dhe kriterëve të specifikuar në këtë rregullore. 3. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.”

Në nenin 24 të VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, parashikohet shprehimisht se: *“Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëri/studio, janë: 1. Për studimin e projektimin: a) Të jenë regjistruar si person juridik, sipas dispozitave ligjore, për të ushtruar veprimtari në studim e projektim; b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për studim e projektim; c) Të mos kenë detyrime tatimore të papaguara, si dhe të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi. 2. Për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi: a) Të jenë regjistruar si person juridik, sipas dispozitave ligjore, për të ushtruar veprimtari në mbikëqyrje e kolaudim; b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim; c) Të mos kenë detyrime tatimore të papaguara, si dhe të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi. Në rastet e shoqërive të huaja, që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale, zbatohen të njëjtat kushte paraprake si shoqëritë vendase.”*

III.3.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit

provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.10. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, referuar dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton, se në përmbushje të pikës 2.3.2 të shtojcës nr. 9 “kriteret e veçanta të kualifikimit”, BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk ndër të tjera ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon: Akt marrëveshje bashkëpunimi, datë 12.03.2026 lidhur ndërmjet “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk, Licencë nr. 6130/14, në Projektim, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në emër të shoqërisë “Infratech” shpk, Licencë nr. 6932/10, në Projektim, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në emër të shoqërisë “A.SH Engineering” shpk, Licencë nr. 6408/32, në Projektim, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në emër të shoqërisë “Gjeokonsult & Co” shpk.

III.3.11. Referuar arsyetimit të autoritetit kontraktor rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk, është s’kualifikuar për mospërmbushje të kërkesës, nga anëtarë i bashkimit të operatorëve “INSTANT.AL” SHPK” shpk me arsyetimin se: “Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik INSTANT.AL (pjesë e bashkimit të operatoreve ekonomik) , rezulton se ky operator nuk ka paraqitur licensene e kerkuar nga AK ne plotesim te pikes 2.3.1 te kriterëve te vecanata te kualifikimit”. Referuar dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 ndër të tjera ka përcaktuar se: “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 3.c2 Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 5.b Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi
- 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime
- 5.e Vepra te trajtimit te ujit
- 5.f Projekte vepra hidroteknike, galeri e tunele hidrulike, marrje uji, shkarkimi.
- 8.a Rivelime inxhinierike.
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.e Studime e Projektme hidrogjeologjike
- 12d Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse si: hidrocentrale, termocentrale, porte, aeroporte, tunele per vepra hidroteknike, bazamente per ngarkesa te mbedha dhe objekte industriale.
- 12e Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet e shpate me qendrueshmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrfeta me mundesi lengezimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

III.3.12. Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kritereve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Referuar Akt marrëveshjes së bashkëpunimit, datë 12.03.2026 lidhur ndërmjet “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk në nenin 3 – pjesëmarrja në realizimin e shërbimit përcaktohet si vijon: “Pjesëmarrja në grup përcaktohet sipas raporteve 83.3 % shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk, 4 % shoqëria “Infatech” SHPK, 4 % “Instant.Al” shpk dhe 8.7 % shoqëria “A.SH Engineering” shpk. Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk do të ketë të drejtën e përfaqësimit në kontaktet me investitorin dhe cdo përfaqësim tjetër që do të jetë i nevojshëm gjatë kryerjes së aktivitetit të realizimit të kontratës së shërbimit. Ndërsa në nenin 5 Ndarja e punimeve dhe detyrimet përcaktohet se: “*Të gjitha shoqëritë do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, kapacitetet financiare dhe eksperiencën e tyre si grup i vetëm, përkatësisht në përputhje me ndarjen e punimeve në pjesëmarrje, për të realizuar me sukses kontratën, ku përcaktohet se Shoqëria “Gjeokonsult & Co” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe prijhektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimit e kërkuara në DST sipas pikave të liçencës:*

3.Projektues konstruktor, pikat, c-2

4.Projektues instalator, pikat, c

5.Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f.

8.Projektues gjeodet, pika a,e

9.Studim gjeologo-inxhinierike-hidrogeologjike, pika e

12. studime të sizmiologjisë inxhinierike, pika d dhe e

Shoqëria “Infratech” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë:

Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialist që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës:

Staf mbështetës hidroteknik

Shoqëria “Instant. AL” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës IT.

Shoqëria “A.SH Engineering” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: 5.Projektues vepra hidraulike pikat b,c,e,f. 8.Projektues gjeodet, pika a, e.

Nga verifikimi i licencave të dorëzuar në SPE, si dhe nga verifikimi i dokumentave të tenderit kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën nr. 9 të dokumentave të tenderit, si dhe referuar akt marrëveshjes për bashkimin e operatorëve ekonomikë, Komisioni konstaton, se operatorët ekonomikë pjesë e BOE ankimes kanë realizuar ndarjen e pjesëmarrjes në shërbim në përqindje dhe bazuar në natyrën e pjesëmarrjes në shërbim, sipas të cilës rezulton se operatori ekonomik “Instant.AL” SHPK anëtar i BOE, ka do të kryejë 4 % të shërbimit dhe sipas natyrës së shërbimit *do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës IT.* Referuar specifikës së procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe referuar përqindjes së pjesëmarrjes në shërbim të përcaktuar në akt marrëveshje operatori ekonomik “Instant.AL” SHPK, pjesë e BOE ankimes duhet të jetë jete operator i licensuar në studim projekte. Referuar arsytimit të BOE ankimes se: “[...] Sa i përket shoqërisë “INSTANT.AL” sh.p.k., kjo e fundit nuk angazhohet në detyra të projektimit, por ka rol të përcaktuar qartë si staf mbështetës në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), në përputhje me ndarjen funksionale të përcaktuar në Akt-Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe konkretisht në Nenin 5 të saj, i cili përcakton në mënyrë të detajuar shpërndarjen e detyrimeve dhe specialiteteve ndërmjet anëtarëve të BOE-së”, Komisioni gjykon, se referuar pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “3. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, pjesëmarrja e operatorit ekonomik “Instant.AL” shpk nuk mund të konsiderohet si rol mbështetës në fushën e teknologjisë së informacionit, pasi operatori është pjesë e BOE dhe jo subjekt mbështetës dhe anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë kanë përcaktuar qartësisht ndarjen në përqindje të shërbimit që do të realizohet. Akoma më tej edhe vetë BOE ankimes ka përcaktuar që Shoqëria “Instant. AL” shpk në kuadrin e bashkëpunimit do të realizojë: Realizimin e studimit dhe projektimit të objekteve që lidhen me specialitetet që mbulohen nga specialistët që posedojnë përcaktimet e kërkuara në DST sipas pikave të licencës: Staf mbështetës IT, nisur nga specifika e procedurës së prokurimit studim projektimi operatori ekonomik duhet të provojë që disponon licencë në projektim sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, pasi edhe pse shërbimi i siguar do të jetë në fushën IT, operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka eksperiencë dhe licencë në fushën e studim projektimit, pasi vetë operatorët ekonomikë pjesë e bashkimit kanë përcaktuar në akt marrëveshje, njëkohësisht edhe ndarjen në përqindje të angazhimit të marrë përsipër. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje

me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pretendimet e BOE ankimues nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit si vijon: “[...] Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik (pjesë e bashkimit të operatoreve ekonomik) si dhe nga verifikimet e kryera nga kvo, ky operator nuk perbush piken

a) të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, si më poshtë:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; Nga verifikimi rezulton se ky operator ekonomik nuk ka në objektin e tij të veprimtarisë studim projektimit.

Theksjome faktin se plotesimi i këtij kriteri është kryesori dhe kriteri baze për çdo shoqëri e cila konkuron për një kontratë publike [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1 Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ *Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :*

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

III.4.2 Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, Pjesa II: “Shkaqet e përjashtimit”, pika A: Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>

<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime _____ nëse _____ vlerësohet _____ e nevojshme _____</i></p>

III.4.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit BOE ankimues ka dorëzuar në SPE:

- Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Instant.AL” SHPK të nënshkruar dhe vulosur
- Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Infratech” SHPK të nënshkruar dhe vulosur
- Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Gjeokonsult & CO” SHPK të nënshkruar dhe vulosur
- Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “A.SH Engineering” SHPK të nënshkruar dhe vulosur

III.4.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.4.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe 27 jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.4.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale

llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.4.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

III.4.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 20të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës*

së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) 2) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.4.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.4.10 Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues me arsyetimin se: *“Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik (pjesë e bashkimit të operatoreve ekonomik) si dhe nga verifikimet e kryera nga kvo, ky operator nuk perbush piken*

a) të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, si me poshte:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; Nga verifikimi rezulton se ky operator ekonomik nuk ka në objektin e tij të veprimtarisë studim projektimet. Theksjome faktin se plotësimi i këtij kriteri është kryesori dhe kriteri baze për çdo shoqëri e cila konkuron për një kontratë publike.”, si dhe verifikimi i dokumentave të tenderit Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” pika 1/a, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: *“Ofertuesi deklaron se:a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv”, në përmbushje të kriterit BOE ankimues ndër të tjera ka dorëzuar: Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Instant.AL” SHPK të nënshkruar dhe vulosur, ku ka deklaruar “Operatori ekonomik është është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme (Provohet nga ekstrakti Tregëtar i QKB-*

së). Nisur nga arsyeja e skualifikimit si dhe nga verifikimi në QKB i Ekstraktit të Regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” i subjektit “Instant.AL” shpk rezulton objekti i aktivitetit: *“Import dhe eksport, tregti me pakicë dhe shumicë, konsulencë teknike, instalim, mirëmbajtje, assemblim pjesë të veçanta dhe krijim produkt të ri dhe sisteme komplekse për: kompjuterike, kancelari, telefoni, elektronike, mekanike, të telekomunikacionit, elektrike, hidraulike, i sistemeve të fonisë, sistemeve të alarmit kundra vjedhjes, sistemeve të alarmit kundra zjarrit, sistemeve të rrufepritjes, sistemeve të kamerave të survejimit dhe vëzhgimit CCTV, sistemeve të akses kontrollit, sisteme UPS, stabilizatorë, gjeneratore, radio ndërlihdje, sisteme me fibër optike etj. Tregti me pakicë dhe shumicë për kondicionera tokësor dhe mural, sisteme multisplit dhe inverter, riparime kondicionera dhe shërbime mbushje me gaz kondicioneri. Konsulencë teknike, riparim dhe servis për paisje kompjuterike dhe elektronike. Shërbime dixhitalizimi të dhënash audio dhe video. Shërbime informatike dhe telefonike. Shpërndarje interneti. Krijim dhe mirëmbajtje faqesh interneti. Programim, krijim dhe shpërndarje programe softëare të bëra me porosi për klientin. Mirëmbajtje dhe instalime softëare për liçensa dhe softëare egzistues. Shërbime IT për software në Cloud, Rrjeta online dhe Cybersecurity, Shërbim printimi I menaxhuar, Design, programim, menaxhim i faqeve te internetit, i aktiviteteve promocionale me perdorimin e postes elektronike (e-mail), i zonave reklamore ne faqe te internetit te paleve te treta nepermjet banner dhe/ose mjeteve te tjera promocionale interaktive, i programeve informatike si psh: ëidgets, mobile apps, social netëork apps, interactive e-cards, i fushatave reklamore ne gazeta, revista, TV, radio, si edhe ne vende publike. Programim dhe menaxhim i aktivitetit promocional me perdorim te SMS. Programim dhe menaxhim i bazave te te dhenave informatike te klienteve per arsye promocionale. Keshillim te klienteve per ceshtje marketingu, marredhenie me publikun dhe te brandit. Shitje dhe/ose blerje e produkteve e sherbimeve ne internet (ecommerce). Te zhvilloj aktivitet ne fushen e prodhimit dhe shitjes se software(programe), instalim, venie ne pune , trajnime, konsulenca e te tjera ndihmese per kete fushe. Shitje online Tregtimin e pajisjeve elektronike, kamerave dhe sistemeve te sigurise. Ofrimi i sherbimeve te ndryshme si domaine dhe hosting. Blerje shitje Hardware, kompjutera, aksesore dhe pjese te tyre, kompjutera, hardëare dhe aksesore te tjere, instalim e mirmbajtje te tyre, Tregtim me shumice dhe pakice i te gjithave artikujve kancelarike, kompjuterike, printerave, artikuj zyrash, bojra per printera,artikujelektrike, informatik, elektronik, artikuj te ndryshme,multimedia, fotografike. Asistence teknike, instalime,riparime dhe mirmbajtje e te gjithave paisjeve elektronike, kompjuterike dhe printimit. Montim dhe mirembajtje tesistemeve te vezhgimit, sigurise dhe audio, si dhe instalime elektrike te cdo lloji. Tregtim i materialeve te konsumit dhe pjeseve per artikujt kompjuterike, elektrike dhe printimit.Krijim paketa programesh per fusha te ndryshme, animacion i kompjuterizuar dhe sherbime te tjera software. Mirembatje faqe web ndertimi faqe web,dizenjim, marketing, menaxhim rrjetet sociale. Furnizim vendosje kondicioner, pajisje audiovizive, elektrike. Materiale ndertimi, hidrosanitare. Mobilje dhe cdo aktivitet tjeter tregtar qe lidhet ne menyre te drejtetperdetjte ose terthorazi me objektin e veprimtaris dhe qe eshte ne perputhje me ligjislacioni ne fuqi”, ndërkohë referuar objektit të procedurës së prokurimit: “Studim Projektim per Rrjetin Ujësjellës dhe Kanalizime, Korabi”, si dhe referuar specifikimeve teknike të dokumentave të tenderit, rezulton se operatori ekonomik “Instant.AL” SHPK anëtar i BOE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit nuk ka ne objektin e tij te veprimtarise studim projektimet, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e përgjithshëm të kualifikimi pikën (1/a), të shtojcës nr. 9 të dokumentave të tenderit.*

Akoma më tej bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe referuar dokumentave të tenderit përcaktohet qartësisht se Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Pra kriteret e përgjithshme të kualifikimit duhet të përmbushen nga secili prej anëtarëve pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik. Sa më sipër arsyeja e skualifikimit të KVO-së është e drejtë.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5 Lidhur me pretendimin e BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk për anulimin e procedurës së prokurimit dhe modifikim të dokumentave standarde të tenderit (DST) për shkak të kritereve të paqarta, kontradiktore dhe konfuze, Komisioni thekson, se bazuar në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku përcaktohet shprehimisht se: *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*, BOE ankimues ka patur në dispozicion momentin procedural për kundërshtimin e dokumentave të tenderit dhe nuk ka ushtruar këtë të drejtë. KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74860-02-01-2026, me objekt “Studim Projektim për Rrjetin Ujësjellës dhe Kanalizime, Korabi”, me fond limit 52,116,417.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “GJEOKONSULT & CO” shpk & “INFRATECH” shpk & “INSTANT.AL” shpk & “A.SH.Engineering” shpk.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

